

# **R E F O R M E**

## **SEKTORI I FURNIZIMIT ME UJE DHE KANALIZIMEVE, PAS TRANSFERIMIT TE SHOQERIVE TEK PUSHTETI VENDOR**

**PLANI DY-VJEÇAR  
2007 – 2009**

**Prof. Dr. Sali BERISHA, KRYEMINISTER I SHQIPERISE**

**Për detaje:**

**Z. Sokol OLLDASHI,**  
Ministër i Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit

**Enkelejda PATOZI,**  
Këshilltare e Kryeministrit për Çështjet e Ujit

**23 KORRIK 2008**

## *Dita botërore e ujit në Shqipëri, 22 mars 2008*

*Uji është burimi më me vlerë i botës dhe i Shqipërisë.*

*Shprehja “Uji është Jetë” është një e vërtetë që nuk mund të mohohet. Në vitin 1992, Kombet e Bashkuara, në klimën globale për të theksuar rolin që luan uji në ekzistencën tonë të përditshme, deklaruan se çdo vit, 22 marsi do të njihet dhe do të festohet në mbarë botën si Dita Botërore e Ujit. Në emër të Qeverisë shqiptare, dua të njoh këtë deklaratë të Kombeve të Bashkuara dhe të them se, Shqipëria mbështet qëllimet e Kombeve të Bashkuara dhe objektivin e tyre të përgjithshëm “Ujë për të Gjithë”. Si shqiptarë ne jemi të bekuar, pasi kemi burime të mjaftueshme natyrore uji të freskët të një cilësie të lartë, që plotëson të gjitha nevojat tona sociale dhe ekonomike. Sfidat, me të cilat hasemi, janë: të bëjmë të disponueshme këto burime për qytetarët tanë dhe për sektorët e ndryshëm të ekonomisë tonë, në një mënyrë të pandërprerë, të sigurt, me kosto efektive, në mënyrë që e gjithë shoqëria jonë të mund të përfitojë prej tyre.*

*Shqipëria, duke punuar me partnerët e saj dypalësh dhe shumëpalësh në këtë sektor kritik, vazhdon që të arrijë një progres të matshëm në këtë drejtim. Orët e shërbimit ditor po fillojnë të shtohen në të gjithë vendin, humbjet e ujit po fillojnë të ulen dhe cilësia e ujit të pijshëm vazhdon të jetë e një standarti të lartë. Unë iu garantoj se, Qeveria nuk do të rendë së investuari në këtë sektor kritik, derisa të gjithë shqiptarët të kenë një shërbim të sigurt dhe të pavarur të furnizimit me ujë, në përputhje me standartet e Bashkimit Evropian. Në këtë ditë, është e rëndësishme që ne të njohim se Kombet e Bashkuara e kanë deklaruar këtë vit, 2008-ën, si Viti Ndërkombëtar i Sanitetit. Ne duhet të mbajmë mend gjithmonë se privilegji që kemi, përsa i përket burimeve të shumta të furnizimeve me ujë në Shqipëri, duhet të jetë i balancuar me përgjegjësinë që duhet të ushtrojmë në*

*menaxhimin, siç duhet, të burimit të furnizimit me ujë, pasi ta kemi përdorur atë.*

*Le të mos harrojmë se pavarësisht nëse jetojmë në Korçë, Pogradec, Gjirokastrë, Kukës, Shkodër, Krujë, Tiranë, Lezhë, ose Fier, dhe në fakt në çdo anë të Shqipërisë, i gjithë uji që përdorim dhe shkarkojmë endet përgjatë të gjithë vendit, në përrrenjtë dhe lumenjtë tanë dhe derdhet në det. Ne duhet dhe do t'i mbrojmë këto përrrenj dhe lumenj, duke trajtuar këtë ujë të përdorur, përpara se ta shkarkojmë në det. Ky proces i mbrojtjes së ujërave natyrore ka filluar tashmë dhe janë bërë investime në Korçë, Pogradec, Shkodër, Krujë, Tiranë, Lezhë, Durrës, Kavajë, Sarandë dhe Vlorë për të përmbushur këtë sfidë. Vija jonë bregdetare, me ulerat e saj turistike dhe çlodhëse, është burim që duhet të mbrohet dhe që do të mbrohet prej nesh për të gjithë brezat e mëpasshëm. Në përmbujllje të deklaratës së Ditës Botërore të Ujit, dua të përfitoj nga rasti që të përgëzoj punën e bërë nga shumë gra dhe burra profesionistë, të cilët punojnë pa u lodhur për këtë sektor, në mbarë vendin, për të na furnizuar me ujë çdo ditë. Puna juaj është shumë e vyer dhe e kuptuar nga i gjithë publiku i gjerë.*

*Kini besim se Qeveria Qendrore njeh dhe ju falenderon për dedikimin dhe përpjekjet dhe se, gjatë procesit aktual të decentralizimit të përgjegjësive dhe transferimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve tek pushteti vendor, ne kemi nevojë që ju të jeni edhe më shumë të dedikuar në punën tuaj të nderuar. Ne e dimë se qeveritë vendore janë po aq të shqetësuara për çështjet kritike të sistemeve të sigurta dhe të besueshme të ujës-jellës-kanalizimit dhe Qeveria Qendrore është e angazhuar për të realizuar të gjitha burimet e arsyeshme për investime kapitale, për të vazhduar me përpjekjet e saj për të përmirësuar shërbimin dhe performancën e shërbimit të ujës-jellës-kanalizimeve.*

*Le të ngremë një gotë ujë së bashku “Çezuar ditën e ujit!”*

*Sali Berisha*

# PËRMBAJTJA

## PJESA E PARË

Statusi i politikave në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve \_\_\_\_\_ 3

## PJESA E DYTË

### MASAT E NDËRMARRA NË MBËSHTETJE TË REFORMËS

#### 1. Iniciativa Ligjore

1.1	Rishikimi i strategjisë kombëtare të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve	3
1.2	Rishikimi i ligjit të burimeve ujore	3
1.3	Forcimi i entit rregullator të ujit	5
1.4	Mbështetje sociale për shtresat më të varfra të shoqërisë	5
1.5	Lidhja e kontratave të shërbimit me bazë treguesit e punës	5
1.6	Miratimi i Rregullores / Kodi i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në Shqipëri	5

#### 2. Iniciativa Administrative

2.1	Hartimi i planeve 5-vjeçare te biznesi për shoqëritë	6
2.2	Zbatimi i programit: reduktimi/ eliminimi i subvencioneve shtetërorë	6
2.3	Drejt rajonalizimit të shoqërive Ujësjiellës-Kanalizime	6
2.4	Politika e investimeve kapitale sipas rezultateve të punës	6
2.5	Hartimi i planeve të zonave të mbrojtjes sanitare për burimet e ujit	6
2.6	Manual: Si të përgatisim projekte teknike sipas standarteve të BE	6
2.7	Vazhdimi i vlerësimit krahasues të treguesve të punës	6
2.8	Zbatimi i programit kombëtar të trajnimit dhe çertifikimit	7
2.9	Pjesëmarrja e tregut privat vendas dhe të huaj	7
2.10	Mbështetje dhe bashkëpunim për koordinimin e donatorëve	7
2.11	Përfshirje dhe bashkëpunim me shoqatën e ujësjiellës-kanalizimeve	8
2.12	Vazhdimësi për programin e praktikës së punës për inxhinierët e rinj	8

#### 3. Iniciativa për Financime dhe Projekte

3.1	Investime kapitale vendase e të huaja	8
3.2	Mbështetje iniciativave për ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujit të ndotur	9

#### 4. Aneks

Tabela 1: Investime kapitale – Sektori i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve 2008	10
Tabela 2: Plani – Impiante te trajtimit të ujit të ndotur të kanalizimeve 2005 – 2010	13

## SHKURTIMISHT, STATUSI I POLITIKAVE NË SEKTORIN E FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE

Në dhjetor të vitit 2007, të gjitha shoqëritë ujësjellës-kanalizime, me borxhe të eliminuara, u transferuan pranë pushteteve vendore. Ky proces ka qenë dhe një ndër angazhimet më serioze të Qeverisë, i cili nuk mbeti në letër, nuk u politizua, - sot një realitet.

### Statusi aktual i transferimit:

Vetëm 80% të Shoqërive kanë themeluar Asamblatë e tyre Aksionare dhe Këshillat e reja Mbikëqyrëse. METE ka marrë të gjitha masat që të ndihmojë pushtetet vendore për te përfunduar me sukses këtë proces. Nëse kjo s'ndodh, atëherë përse pushtetet vendore janë të interesuara për fonde dhe Qeveria Qendrore, pa hezitim, i ka aprovuar ato? Gjithashtu, për të mbështetur transferimin, Qeveria ka shpallur **për herë të parë** në Shqipëri **REFORMË NË SEKTORIN E FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE**.

[gruli@mete.gov.al](mailto:gruli@mete.gov.al); [bnishani@moi.gov.al](mailto:bnishani@moi.gov.al);  
[fponi@moi.gov.al](mailto:fponi@moi.gov.al); [shshehu@minfin.gov.al](mailto:shshehu@minfin.gov.al);  
[sristani@mpptt.gov.al](mailto:sristani@mpptt.gov.al); [mvlakshi@mete.gov.al](mailto:mvlakshi@mete.gov.al);

### Objektivi kryesor i reformës:

Decentralizimi / komercializimi i mëtejshëm i sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, për të bërë të mundur që shoqëritë të jenë me vetëfinancim, me një plan afatgjatë dhe të qendrueshëm, me qëllim përmirësimin e treguesve të punës dhe përmirësimit të gjitha detyrimeve ndaj konsumatorit. Masat e ndërmarra për të mbështetur këtë reformë, janë në 3 drejtime:

- iniciativa ligjore,
- iniciativa administrative,
- iniciativa për projekte dhe financime.

### Aktorë të përfshirë:

Gjithsej janë 20 institucione të pushtetit qendror, i gjithë pushteti vendor si dhe komuniteti i donatorëve. Nga Pushteti Qendror: Këshilli i Ministrave, Këshilli Kombëtar i Ujit, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave, Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë; Ministria e Integritit, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Enti Rregullator i Ujit, Shoqata e Qarqeve, Shoqata e Bashkive, Shoqata e Komunave, Shoqata e Ujësjellës Kanalizimeve e Shqipërisë, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit.

**Kjo reformë do të drejtohet nga Z. Sokol Ollidashi**, Ministër i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

[sollidashi@mpptt.gov.al](mailto:sollidashi@mpptt.gov.al)

## MASAT E NDËRMARRA NË MBËSHTETJE TE REFORMËS

### 1. INICIATIVA LIGJORE

#### 1.1 Rishikimi i Strategjisë Kombëtare të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve

Këshilli i Ministrave, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, si dhe Drejtorinë e Koordinimit të Strategjive, ka ndërmarrë iniciativën për të rishikuar Strategjinë Kombëtare të Furnizimit me ujë dhe Kanalizimeve, të aprovuar me VKM Nr 706, datë 16.10.2003.

Strategjia e rishikuar nënvizon reformat e politikave sektoriale në planin afatshkurtër 2010, afatmesëm deri në vitin 2015 dhe afatgjatë deri në vitin 2020. Strategjia është konsultuar me Grupet Këshillimore (e kryesuar nga Ministri i MPPTT), donatorët, Komiteti i Planifikimit të Strategjive (kryesohet nga Kryeministri). Strategjia do të kalojë për komente paralel tek ministrinë e linjës, si dhe tek Grupi Parlamentar i Veprimtarive Prodhuese. Së fundi, Strategjia pritet të aprovohet me Vendim të Këshillit të Ministrave.

[sristani@mpptt.gov.al](mailto:sristani@mpptt.gov.al)

#### 1.2 Rishikimi i Ligjit të Burimeve Ujore

Në kuadër të Menaxhimit të integruar të burimeve ujore dhe kërkesës bazë të Direktivës Evropiane për Ujin, tetor 2000, e detyrueshme për të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Evropian, Këshilli Kombëtar i Ujit i kryesuar nga Kryeministri, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, ka ndërmarrë iniciativën për rishikimin e Ligjit të Rezervave Ujore Nr. 8093, datë 21.03.1996.

Theksojmë se është e rëndësishme që Shqipëria qysh sot duhet të integrojë premisat e Direktivës në fjalë me detyrat e institucioneve përkatëse, veçanërisht ato të Këshillit Kombëtar të Ujit dhe këshillave të baseneve ujore.

[lxhuvli@moe.gov.al](mailto:lxhuvli@moe.gov.al); [albert.gajo@mie.gov.al](mailto:albert.gajo@mie.gov.al)

Një aspekt tjetër i fuqizimit të këtyre institucioneve është pavarësia financiare për një mirëmenaxhim të shfrytëzimit të burimeve ujore. Kështu, KKKU miratoi strukturën e tarifave për shfrytëzimin e burimeve ujore. VKM nr 23, datë 09. 01.2008

[agaruli@moe.gov.al](mailto:agaruli@moe.gov.al)

Gjithashtu, Qeveria Shqiptare, me fonde të Buxhetit të Shtetit, ka ndërmarrë iniciativën për të vlerësuar kërkesën për ujë për zonën turistike Gjiri i Lalzit – Karpën, vlerësimin e burimeve ekzistuese, si dhe mundësinë për të rritur kapacitetet deri në vitin 2036.

[h teme@dpuk.gov.al](mailto:h teme@dpuk.gov.al); [nbraho@gmail.com](mailto:nbraho@gmail.com)

### 1.3 Forcimi i Entit Rregullator të Ujit

Me iniciativë të ERRU dhe në bashkëpunim me Këshillin e Ministrave, në dhjetor të 2007 u ndërmor iniciativa serioze për rishikimin e ligjit të Entit Rregullator të Ujit, i cili rregullon monopolin natyror ujë, në funksion të vendosjes së tarifave, sipas një procedure të miratimit paraprak nga pushteti vendor pronar. Ligji Nr. 9915 u aprovua nga Parlamenti shqiptar më 12.05.2008.

[anvi.dervishi@gmail.com](mailto:anvi.dervishi@gmail.com)

Pas konsultimeve që Kryeministria ka kryer me Qeverinë Gjermane dhe Bankën Gjermane për Zhvillim (KfW), ato vendosën të ripërtërijnë fondin e vënë në dispozicion qysh me 1999 për rivlerësimin e funksioneve, kompetencave dhe ngritjen e kapaciteteve teknike dhe administrative të Entit Rregullator të Ujit. [vkuko@km.gov.al](mailto:vkuko@km.gov.al)

Duke qenë një vend i vogël dhe me kapacitete të kufizuara, me burime njerëzore të kualifikuara mbi rregullatorin shumësektorial, vërejmë se duhet marrë në konsideratë mundësia e shkrirjes së Entit të Ujit me atë të Energjisë, pra krijimi i një enti rregullator për të dy shërbimet. Kjo praktikë ndeshet edhe në vende të tjera dhe është e llogjikshme, pasi të dy fushat janë mjaft të ngjashme, madje dhe dokumenti i paktit të stabilitetit kërkon që entet si: ujë, energji, transport, gaz dhe telekomunikacion, të jenë nën një ent rregullator të vetëm dhe shumësektorial.

[avokshi@km.gov.al](mailto:avokshi@km.gov.al)

### 1.4 Mbështetje Sociale për Shtresat më të Varfra të Shoqërisë

Uji është nevojë jetike dhe si i tillë nuk mund t'i mohohet konsumatorit, sepse ky i fundit nuk është në gjendje të paguajë. Nga ana tjetër, shoqëritë ujësjellës-kanalizime nuk janë organizma të mbështetjes sociale, por ato mbijetojnë nëpërmjet të ardhurave që sigurojnë nga shërbimet që kryejnë.

Për të dyja këto arsye, është thelbësore që të themelohet një politikë e qartë në lidhje me sigurimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, të tillë që të mbulohen nevojat bazike të të gjithë konsumatorëve të varfër.

Është përgjegjësia e Ministrisë së Brendshme dhe e Ministrisë së Financave, e cila në bashkëpunim me pushtetin vendor dhe shoqëritë ujësjellës-kanalizime, të përgatisë një studim mbi aftësinë për të paguar për shërbimet e ofruara për këto shtresa të shoqërisë, duke reflektuar normat e njohura ndërkombëtare për nevojat bazike të furnizimit me ujë.

[sherefedinshehu@yahoo.com](mailto:sherefedinshehu@yahoo.com); [fponi@moi.gov.al](mailto:fponi@moi.gov.al)

### 1.5 Lidhja e kontratave të shërbimit me bazë treguesit e punës

Drejtoria e Përgjithshme Ujësjellës Kanalizime / MPPTT, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, Entin Rregullator të Ujit, si dhe me Ministrinë e Brendshme, po zhvillojnë me Bankën Botërore, një Model Standart për Marrëveshjen e Performancës që duhet negociuar e nënshkruar nga pushtetet vendore me shoqëritë e tyre përkatëse të Ujësjellës-Kanalizimeve, me qëllim programimin e reduktimit gradual të subvencioneve nga shteti për operim e mirëmbajtje, i veçantë për çdo shoqëri.

Ky program do të jetë pjesë e kontratës që do të nënshkruhet nga pushtetet vendore pronare dhe shoqërive U-K përkatëse, për ofrimin e shërbimit sipas standardeve dhe cilësisë së punës.

[vbibolli@dpuk.gov.al](mailto:vbibolli@dpuk.gov.al)

### 1.6 Miratimi i Rregullores-Kodi i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në Shqipëri

MPPTT / Drejtoria e Përgjithshme Ujësjellës Kanalizime, në bashkëpunim me GTZ, po harton rregulloren standarte (kodin) e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, për një përdorim cilësor të ujit, 24 orë dhe me presion, si dhe largim e trajtim të ujit të ndotur të kanalizimeve.

[lindimetaliaj@yahoo.com](mailto:lindimetaliaj@yahoo.com); [apapaproko@gtz.de](mailto:apapaproko@gtz.de)

#### Kodi i furnizimit me ujë

rregullon të drejtat dhe detyrat e administratorit ndaj konsumatorit dhe pronarit, përcakton detyrimet për një përdorim të kontrolluar të ujërave të pijshëm, përcakton detyrimin për të paguar tarifat e shërbimi për lidhjen, përdorimin e sistemit të ujërave të pijshëm dhe trajtimit të tij, të gjitha këto në përputhje me legjisllacionin në fuqi dhe standartin shqiptar të ujit të pijshëm STASH 3904-88, datë 01.07.1988, të cilësisë së ujit të pijshëm dhe trajtimit të tij. [ukkosha@yahoo.co.uk](mailto:ukkosha@yahoo.co.uk)

Aktualisht, Ministria e Shëndetësisë po rishikon STASH 3904-88, me qëllim që të përfshihet edhe cilësia e ujërave sipërfaqësorë, të destinuara për pirje (Bovilla, Maskuria), të cilat nuk ishin marrë më parë në konsideratë. [albanlylli@yahoo.co.uk](mailto:albanlylli@yahoo.co.uk)

#### Kodi i kanalizimeve

rregullon të drejtat dhe detyrat e administratorit ndaj konsumatorit dhe pronarit, përcakton detyrimet për një largim të kontrolluar të ujërave të ndotura, përcakton detyrimin për të paguar tarifat e shërbimit për lidhjen, përdorimin e sistemit të ujërave të ndotura dhe trajtimin e ujit të ndotur, të gjitha këto në përputhje me legjisllacionin në fuqi dhe standartet e ujërave të ndotura, si dhe shkarkimeve të tyre. Për referencë VKM Nr 145 dt. 26.02.1998. [shani@albmail.com](mailto:shani@albmail.com)

## 2. INICIATIVA ADMINISTRATIVE

### 2.1 Shoqëritë ujësjellës-kanalizime do të hartojnë plane 5-vjeçare biznesi

Drejtoria e Përgjithshme Ujësjellës Kanalizime / MPPTT, në bashkëpunim me Bankën Botërore, po zhvillon një Model Standard për hartimin e Planeve të Biznesit dhe Udhëzuesin e saj përkatës, për t'u përdorur nga të gjitha shoqëritë ujësjellës-kanalizime në përgatitjen e planeve të tyre 5-vjeçare. [valuadd@afb.net.al](mailto:valuadd@afb.net.al)

Ky angazhim serioz përgatiti rrugën e shoqërive drejt pavarësisë financiare. Ai është pilotuar me shume sukses në 5 shoqëri si U-K Kavajë, Shkodër, Librazhd, Berat-Kuçovë si dhe në Sarandë. Pritet zyrtarizimi i formës standarte, me qëllim që të gjitha shoqëritë në Shqipëri të punojnë në bazë të një plani 5-vjeçar dhe jo më 1-vjeçar, me të cilin është punuar deri tani. Përfundimi i kësaj iniciative është viti 2008.

[ncenga@dpuk.gov.al](mailto:ncenga@dpuk.gov.al)

### 2.2 Programi për reduktimin / eliminimin e subvencioneve

Drejtoria e Përgjithshme Ujësjellës Kanalizime po përgatit një program të ndarë në faza, mbi reduktimin e subvencioneve, të cilat do të shërbejnë për të mbuluar diferencën ndërmjet tarifave dhe kostos totale. Ky program do të ndërtohet në mënyrë që t'u përgjigjet statusit aktual e buxhetor të pushteteve vendore si dhe do të parashikojë kohën që do t'i duhet shoqërive ujësjellës-kanalizime për të arritur mbulimin e plotë të kostos. Përveç kësaj, ky program i Qeverisë Qëndrore do të trajtojë çështjen e mbështetjes financiare afatmesme, për të siguruar shërbimet ujësjellës-kanalizime.

[sristani@yahoo.com](mailto:sristani@yahoo.com)

Eliminimi gradual i subvencioneve, që akordon Qeveria çdo vit për shoqëritë ujësjellës-kanalizime, pritët të ndodhë brenda 5 viteve të ardhshëm 2007– 2012. Ky program drejtohet nga Drejtoria e Përgjithshme Ujësjellës Kanalizime / MPPTT, në bashkëpunim me Bankën Botërore. [sherefedinshehu@yahoo.com](mailto:sherefedinshehu@yahoo.com), [fponi@ moi.gov.al](mailto:fponi@moi.gov.al)

### 2.3 Plani: Zonat e mbrojtjes sanitare

Këshilli Kombëtar i Ujit, Këshillat e Baseneve, Inspektorati Sanitar Shëndetësor, ka ndërmarrë iniciativën për hartimin / miratimin e Planeve të Zonave të Mbrojtjes Sanitare për Burimet e ujit për pirje. Referencë: Ligji Nr. 8093, datë 21.3.1996 "Për Rezervat Ujore", VKM nr. 145, datë 26.02.1998, "Rregullore higjieno–sanitare për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mbikqyrjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm".

[lxhuvelli@moe.gov.al](mailto:lxhuvelli@moe.gov.al)

## 2.4 Drejt rajonalizimit të shoqërive

Drejtoria e Përgjithshme Ujësjellës Kanalizime / MPPTT, në bashkëpunim me Qeverinë Japoneze, po kryen një studim mbi rajonalizimin e mëtejshëm të shërbimeve ujësjellës-kanalizime në Shqipëri, i cili pritët të përfundojë para dhjetorit 2008. Në përfundim do të jepen rekomandime për Qeverinë Shqiptare se kur bashkimi (rajonalizimi) i shërbimeve mund të konsiderohet si një mënyrë për të përmirësuar efektivitetin e tyre, përfitimin e investimeve kapitale, në funksion të ekonomisë së shkallës, si dhe cilët faktorë që do e ndihmojnë apo pengojnë këtë proces.

Rajonalizimi i shoqërive, pra zvogëlimi i numrit të shoqërive, sipas standarteve të ekonomisë së tregut, me synim grupim të zonave të shërbimit, në një zonë më të madhe, për një tarifë uji më të ulët, është një iniciativë e bazuar në parimin që tarifa të mbulojë kostot. [sristani@mpptt.gov.al](mailto:sristani@mpptt.gov.al)

Pionieri i parë në Shqipëri është bashkimi i shoqërive Ujësjellës Kanalizime Berat dhe Kuçovë, i cili u bë realitet vetëm më 14 maj 2008. Theksojmë se kjo iniciativë nuk ka mundur të realizohet qysh nga viti 2001. Si iniciativë për këtë bashkim janë vënë në dispozicion 6 milion Euro nga Qeveria Gjermane, për ndërtimin e infrastrukturës së sistemit të furnizimit me ujë, e cila do i mundësojë një zgjidhje përfundimtare për ujë këtyre dy zonave. [tzeneli@dpuk.gov.al](mailto:tzeneli@dpuk.gov.al)

### 2.5 Politika e investimeve do të kryhet sipas rezultateve të punës

Investimet në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve aktualisht bazohen në nevojat e shprehura në Strategjinë e Sektorit. Drejtoria e Përgjithshme po punon për të zhvilluar një formulë të re për shpërndarjen e tyre, e cila do të reflektojë një element të lidhur me rezultatet e punës së shoqërive ujësjellës-kanalizime, krahasuar ato me objektivat e paracaktuara. Baza për vlerësimin e rezultateve të punës do të jetë Programi i Monitorimit të Treguesve të Punës dhe Vlerësimit Krahasues të tyre. Pra, akordimi i fondeve për investime kapitale do të bëhet në bazë të rezultateve të punës. [tzeneli@dpuk.gov.al](mailto:tzeneli@dpuk.gov.al)

### 2.6 Udhëzuesi: Si të përgatisim projekte teknike sipas standarteve të BE

Udhëzuesi do të përmbajë udhëzime në lidhje me përgatitjen e projekt-propozimeve për fazën e parafizibilitetit, fizibilitetit, implementimit; rregullat FIDIC (Frëngjisht: Fédération Internationale Des Ingénieurs-Conseils, *Federata Ndërkombëtare e inxhinierëve*); aplikimit për fonde tek EU-IPA. Gjithashtu, ai do të përmbajë informacion të përgjithshëm dhe të fundit për organizatat donatore, BB, EBRD etj., në lidhje me objektet e punës së tyre, projektet, kushtet e kredive etj.

[albert.gajo@mie.gov.al](mailto:albert.gajo@mie.gov.al); [miha@albania.rec.org](mailto:miha@albania.rec.org)

## 2.7 Vlerësimi Krahasues i Treguesve të Punës të Shoqërive UK në Shqipëri

Programi i Monitorimit të Treguesve të Punës dhe Vlerësimit Krahasues të tyre për sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në Shqipëri drejtohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve (DPUK) pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit. Ky Program është mbështetur financiarisht me anë të një kredie të Bankës Botërore.

Programi ka filluar në mars të 2005. Fillimisht në të u përfshinë 30 njësi administrative ujësjellës-kanalizime, ndër të cilat 15 ishin kompani që shërbenin në zonat urbane, 5 kompani rajonale dhe 10 njësi administrimi të bazuara në komuna. Duke qenë se të dhënat e komunave ishin mjaft të pasakta e jo të plota, në vitin 2007, Drejtoria e Përgjithshme vendosi të përfshijë në Program të gjitha shoqëritë ujësjellës-kanalizime që operojnë në Shqipëri. Sipas të dhënave të vitit 2007, popullsia që shërbehet nga këto 54 njësi shërbimi është 2461959 frymë, që përfaqësojnë 78% të popullsisë së përgjithshme të vendit.

Pranë DPUK është ngritur një Njësi Monitorimi, e cila menaxhon Programin. Kjo njësi përbëhet nga tre specialistë, të cilët çdo tremujor mbledhin të dhëna nga ndërmarjet ujësjellës-kanalizime, i analizojnë dhe në bazë të tyre llogarisin treguesit e punës. Njësia e Monitorimit vepron sipas një plani pune të përcaktuar mirë, organizon disa trajnime në vit me shoqëritë e përfshira në Program, zhvillon vizita në to, organizon seminare vjetore për ecurinë në lidhje me Programin, harton raporte, etj.

[vbibolli@dpuk.gov.al](mailto:vbibolli@dpuk.gov.al)

## 2.8 Zbatimi i programit kombëtar të trajnimit dhe certifikimit

Sot në botë është pranuar gjerësisht se me anë të kualifikimeve, sigurohet rritja e kapaciteteve profesionale në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Vetëm me anë të certifikimeve dhe standarteve kualifikuese do të sigurojmë që marrja në punë, ose promovimi i kapaciteteve njerëzore, të jetë transparent dhe jo i politizuar.

Prandaj, do të synojmë një proces që starton me trajnimin e operatorëve, mbi njohuritë për të cilat ata kanë nevojë, duke vijuar me certifikimin ose testimin, pra siguria që njohuritë e marra kanë qenë të kuptueshme e mund të zbatohen lehtësisht nga operatori i shoqërisë.

[fponi@moi.gov.al](mailto:fponi@moi.gov.al); [sristani@mpptt.gov.al](mailto:sristani@mpptt.gov.al);  
[tzeneli@dpuk.gov.al](mailto:tzeneli@dpuk.gov.al)

Çertifikimi është një dëshmi zyrtare për të njohur nivelin e aftësive profesionale, demonstrimin e njohurive të marra, grumbullim eksperience, e gjitha kjo, me synimin për të përmirësuar veprimtarinë e individëve që punojnë në shoqëritë e furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve. Çertifikimi duhet të jetë një proces i vazhdueshëm, për të siguruar që individët t'i ruajnë të qëndrueshme njohuritë e fituara, duke i integruar ato lehtësisht me punët e tyre të përditshme.

Drejtoria e Përgjithshme Ujësjellës Kanalizime / MPPTT, në bashkëpunim me Qeverinë e Luksemburgut, do të fillojë zbatimin e programit të certifikimit për shoqëritë ujësjellës-kanalizime si dhe burimeve njerëzore të pushteteve vendore, të përfshira me këtë shërbim. Ky aktivitet zhvillohet për herë të parë në Shqipëri. [nbraho@gmail.com](mailto:nbraho@gmail.com)

## 2.9 Pjesëmarrja e tregut privat vendas dhe të huaj në administrimin e shoqërive

Sot, është i njohur fakti që kur një shërbim publik funksionon mirë dhe me kosto efektive, ai është gjithmonë opsioni më i mirë për publikun. Pjesëmarrja e sektorit privat do kërkohet atëherë kur sektori publik nuk ka efikasitet, ose për shkak të menaxhimit të dobët, ose sepse sektori publik nuk mund të sigurojë financimin e infrastrukturës së re të nevojshme.

[sristani@mpptt.gov.al](mailto:sristani@mpptt.gov.al)

Industria e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve ka kërkesë të lartë për investime kapitale dhe shpeshherë ndodh, që sektori publik nuk i ka mjetet e duhura financiare për ngritjen apo përmirësimin e infrastrukturës. Në mënyrë të veçantë kjo ndodh me impiantet e trajtimit të ujit të pijshëm dhe të ndotura të kanalizimeve. Prandaj, Drejtoria e Përgjithshme Ujësjellës Kanalizime, (me Bankën Botërore), inicioji një model.

[aguxho@worldbank.org](mailto:aguxho@worldbank.org)

## 2.10 Mbështetje dhe bashkëpunim për koordinimin e donatorëve

Qeveria Qëndrore po lëviz me kujdes, por me vendosmëri drejt rivendosjes së rolit që i takon në përcaktimin e nevojave prioritare në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, nëpërmjet hartimit të një programi për prioritizimin e projekteve, zhvillimit të një plani të qëndrueshëm investimesh kapitale, dhe alokimit të përshtatshëm të fondeve të donatorëve dhe të buxhetit të shtetit, në shërbim të nevojave reale në sektor. Kjo veprimtari e Qeverisë Qendrore lidhet me monitorimin e vazhdueshëm të performancës dhe përmirësimin e matshëm të saj për shoqëritë ujësjellës-kanalizime që marrin këto fonde.

[mdako@km.gov.al](mailto:mdako@km.gov.al)

Koordinimi i donatoreve, në të cilat përfshihen politikat e ujit janë dy: sektori i decentralizimit ose rajonalizimit me përbërje si UNDP, Swiss Cooperation, EC, OSCE, ADC, Council of Europe, EBRD, France, Germany/ GTZ, Italian Cooperation, Spanish Cooperation, Sweden, the Netherlands, USAID, si dhe sektori i ujit me përbërje si WB, ADC, EC, Czech Republic, EBRD, Germany/ KfW Italian Cooperation, Swiss Cooperation, EIB.

[avokshi@km.gov.al](mailto:avokshi@km.gov.al);  
[nevila.como@aidharmonisation.org.al](mailto:nevila.como@aidharmonisation.org.al)

## 2.11 Bashkëpunim me shoqatën e ujësjellës-kanalizimeve të Shqipërisë

[shukalb@afb.net.al](mailto:shukalb@afb.net.al)

Aktualisht, shoqata është bashkë-udhëheqëse e politikave shtetërore në rrugën drejt decentralizimit, komercializimit dhe rajonalizimit të sektorit të ujësjellës kanalizimeve në Shqipëri.

Shoqata vepron me baza plotësisht vullnetare, dhe sot është anëtare me te drejta te plota e Shoqatës Evropiane Te Ujit qysh nga viti 2006.

Bashkëpunimi i qeverise me këtë shoqate ka mundësuar organizimin e konferencave dhe ekspozitave te përvitshme kombëtare te sektorit të ujësjellës kanalizimeve qysh nga viti 2000 e deri me sot, organizime këto te kthyer tashme ne një tradite vjetore e kombëtare ne këtë sektor.

Ne bashkëpunim me MPPTT shoqata ka organizuar dhe vazhdon me organizimin e Programeve Kombëtare te Trajnimit si p.sh. “mbi Kontrollin e Humbjeve te Ujit” – ky seminar është kërkuar te zhvillohet për te dytin vit radhazi, si dhe kursi tjetër kombëtar “Menaxhimi i Aseteve”, i cili do te organizohet gjate muajit korrik 2008.

[sristani@mpptt.gov.al](mailto:sristani@mpptt.gov.al)

Gjithashtu, në bashkëpunim me Qeverinë Gjermane, shoqata ka organizuar seminare rajonale për njohjen e procedurave për përdorimin dhe licencimin e burimeve ujore, ne bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, shoqata po zhvillon për te dytin vit radhazi, programin kombëtar “Miqte e ujit”, i cili synon ndërgjegjësimin e brezit te ri, ne mbrojtje te burimeve ujore.

[hshamata@mash.gov.al](mailto:hshamata@mash.gov.al)

Sigurisht që bashkëpunimi me këtë shoqatë ndërmjetëson për zgjidhje të problemeve ndërkufitare e më gjerë, duke shfrytëzuar lidhjet e shoqatës shqiptare me shoqatat simotra me vendet kufitare, si dhe me shoqatat e tjera të ujit në Ballkan, konkretisht Kosovë, Mal i Zi Maqedoni, Ceki, Hungari, Greqi, Bullgari, etj.

[agaruli@moe.gov.al](mailto:agaruli@moe.gov.al); [avokshi@km.gov.al](mailto:avokshi@km.gov.al)

## 2.12 Programi i praktikës së punës për inxhinierët e rinj të sapodiplomuar

MASH, në bashkëpunim me Shoqatën e UK dhe Fakultetin e Ndërtimit, kanë nënshkruar për herë të tretë marrëveshjen për zhvillimin e Programit të praktikës verore të punës, verë 2008, me studentët që diplomohen në degën inxhinieri hidroteknike dhe inxhinieri mjedisi.

Vitin e parë të programit, 24 studentët iu nënshtruan praktikës me pagesë. Vitin e dytë, studentet praktikantë ishin në garë për 5 vende pune, ofruar nga Bashkëpunimi Teknik Gjermani Shqipëri, kompania private Valuadd Managment services, Kompania private italiane VapoRussa, Shoqëria ujësjellës kanalizime Tirane si dhe Bashkia Kamzë. Vitin e tretë, studentet ishin në garë për 2 kompjuter modernë dhe 20 fjalorë profesional anglisht-shqip, ofruar nga MASH.

[amaliqari@yahoo.com](mailto:amaliqari@yahoo.com)

Sivjet është viti i katërt i organizimit të këtij programi. Eksperienca e deritanishme tregon që kjo praktikeëduhet të jetë e detyruar për të gjithë studentët e sapodiplomuar, ose ato në fazë diplomimi. Kështu, MASH të rishikojë kuadrin ligjor në fuqi, me qellim që kjo traditë e mirë vullnetare të shndërrohet në një disiplinë të detyruar.

[agjoni@mash.gov.al](mailto:agjoni@mash.gov.al)

## 3. INICIATIVA PËR PROJEKTE DHE FINANCIME

### 3.1 Investime kapitale vendase e të huaja

[sristani@mpptt.gov.al](mailto:sristani@mpptt.gov.al), [tzeneli@gmail.com](mailto:tzeneli@gmail.com)

Gjatë dy viteve të fundit 2006 – 2008 sektori ujësjellës-kanalizime në Shqipëri është përmirësuar ndjeshëm, si nga pikëpamja teknike ashtu dhe nga ajo financiare. Kështu, vetëm **për vitin 2008 vlera totale e investimeve në sektor është rreth 7,4 miliard lekë** ku rreth 3,2 miliard lekë janë kontribut i buxhetit te shtetit dhe rreth 4,2 miliard leke janë kontribut i donatorëve të huaj në sektor.

Financimet e donatorëve për vitin 2008 konsistojnë ne:

- Sisteme të reja apo zgjerim të sistemeve ekzistuese të furnizimit me ujë, apo kanalizimeve në zona si Tiranë, Shkodër, Koplik, Durrës, Lezhë, Sarandë, Fier, Vlorë, Korçë, Pogradec, Lushnjë, Berat-Kuçovë, Shkodër fshat, Kavajë etj;
- Ndërtime të impianteve të trajtimit te ujërave të ndotura si: Durrës, Lezhë, Shëngjin, Sarandë, Pogradec dhe Korçë.

Qeveria Shqiptare në prioritetet e saj rendit mbështetje për fushën e turizmit. Në këtë kuadër, janë realizuar vepra të rëndësishme ujësjellësish në Shirokë, Zogaj, Golem, Kavajë, Velipojë, Shëngjin, Ksamil, Vlorë, Sarandë, etj.

Ndërsa, për zgjidhjen afatgjate të furnizimit me ujë të zonës së Durrësit dhe Golemit, me financim të buxhetit të shtetit, është në proces gjetja e burimeve që do të sigurojnë furnizimin 24 orë me ujë në ditë, në këtë zonë turistike.

[nbraho@gmail.com](mailto:nbraho@gmail.com)

Një vëmendje e veçantë në planifikimin e financimeve për investime në UK nga ana e DPUK, i është kushtuar dhe përmirësimit të performancës së shoqërive UK, nëpërmjet financimit të projekteve. Kështu, për një pjesë të mirë të projekteve është hartuar një projekt-ide dhe në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore dhe shoqërinë respektive të UK, u bë planifikimi i fondeve.

Kjo mënyrë planifikimi i ka dhënë fund njëherë e përgjithmonë zgjidhjeve emergjente të problemeve të sistemeve të ujësjellës kanalizimeve, duke bërë të mundur kështu efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e investimeve, duke përmirësuar rezultatet e punës së shoqërive dhe reduktimin e subvencionimit të sektorit, si në Peqin, Has, Kukës, Laç, Mamurras, Sukth, Këneta–Durrës, Puëe, Kodër Marlekaj-Lezhë etj.

Një ndër prioritetet e tjera të DPUK-se është dhe instalimi i matësve për të matur prodhimin e ujit dhe konsumin e ujit nga përdorues të ndryshëm. Kjo do të favorizojë reduktimin e humbjeve të sistemeve si dhe do të orientojë punën e shoqërive, padyshim drejt një menaxhimi dhe operimi më të mirë. Kështu, në buxhetin e vitit 2008 janë planifikuar fonde për këtë qëllim.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar dhe zonave rurale, apo njësite të qeverisjes vendore që nuk janë në zonën e shërbimit të ndonjë shoqërie UK. Kështu, me fonde të grandit konkurues janë parashikuar investime të konsiderueshme në këto zona, si dhe nga orientimi i bërë donatorëve, është bërë e mundur financimi i programit për ujësjellës dhe kanalizime në zonat rurale nga Qeveria Gjermane me njësi zbatuese Fondin Shqiptar të Zhvillimit, me një kredi rreth 10 mil Euro. [adf@albaniandf.org](mailto:adf@albaniandf.org)

Një synim tjetër i MPPTT është dhe koordinimi i financimeve për investime kapitale me fonde nga buxheti dhe i donatorëve. Shembulli i parë pozitiv është financimi i projektit të ujësjellës kanalizime në qytetin e Shkodrës, në të cilin janë duke bashkërenduar punën disa donatore si: KfW, ADA, SECO dhe BE.

[egjondrekaj@yahoo.com](mailto:egjondrekaj@yahoo.com)

### 3.2 Mbështetje iniciativave për ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujit të ndotur

Sot, më shumë se kurrë, duhet të trajtojmë në përgjithësi çështjen e politikave disiplanesh, në lidhje me fushën e trajtimit të ujërave të kanalizimeve në Shqipëri dhe në veçanti, të përcaktojmë se cili do të jetë synimi, në lidhje me nivelin e trajtimit, koston e investimit, standarti referent, teknologjisë së përshtatshme etj. Çështje kryesore që shtrohen sot për zgjidhje:

- Vendosja e standartit të trajtimit të ujit të ndotur, në përshtatje me cilësinë e rivierës pritëse,
- Standarte trajtimi për një kosto të përballueshme,
- Standarte trajtimi, të cilat sigurojnë qëndrueshmëri (përfshirë koston e funksionimit dhe të mirëmbajtjes).

#### Standarti i trajtimit të ujit të ndotur, në përshtatje me cilësinë e rivierës pritëse:

Aktualisht a mundet që pjesë kryesore të Vjosës, Shkumbinit dhe Drinit të vete-pastrojnë ujin e kanalizimeve, të trajtuar mbi nivelin e parë të trajtimit? Nëse po, atëherë pse duhet të mendojmë **sot** për nivel trajtimi sekondar?

#### Standarte trajtimi për një kosto të përballueshme:

Akoma nuk është llogaritur: Sa do të jete kosto për investime kapitale për të trajtuar të gjithë ujin e ndotur teëkanalizimeve në Shqipëri, në nivel sekondar apo më sipër?! Është koha për ta bërë këtë llogari, duke konsideruar ndikimin dhe tek menaxhimi i aseteve për këtë shërbim.

#### Standarte trajtimi të qëndrueshme (të përfshihen, kosto e funksionimit dhe mirëmbajtjes).

Ne vetëm tani po pyesim: A jemi në gjendje të mbajmë në funksionim impiante që sot po i ndërtojmë për herë të parë në Shqipëri? A kemi një plan biznesi, ku përfshihet një kalendar pune, në lidhje me impiantet e trajtimit të ujërave të kanalizimeve në ndërmarrje? A kemi parashikuar ndonjë tarifë, e cila ka në themel edhe pagesën për funksionimin dhe mirëmbajtjen? A është i informuar mjaftueshëm pushteti vendor apo popullsia, se sa do i kushtojë ky shërbim çdo familjeje?

Gjithashtu, është në përfundim studimi për ndërtimin e sistemeve të decentralizuara të trajtimit të ujit të ndotur, që do i shërbejnë zonave me popullsi të vogël dhe të pamundura për t'u lidhur me sistemet e kanalizimeve urbane.

[tzeneli@gmail.com](mailto:tzeneli@gmail.com); [epatozi@hotmail.com](mailto:epatozi@hotmail.com)

Bashkëngjitur: Tabela 1 – Investimet kapitale 2000 – 2008 për sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve; Tabela 2 – Plani i ndërtimit të impianteve të trajtimit të ujit të ndotur të kanalizimeve, 2005-2010. [tzeneli@gmail.com](mailto:tzeneli@gmail.com)

**TABELA 1**  
**INVESTIME KAPITALE NE SEKTORIN E FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE NE SHQIPËRI, 2000 – 2008**

**INVESTIME, UJESJELLES KANALIZIME, 2000 – 2008**

000/leke

Nr.	INVESTIME (ne vite)	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008
<b>INVESTIME TOTALE (lek)</b>		<b>4,092,939</b>	<b>5,441,861</b>	<b>4,605,782</b>	<b>5,821,829</b>	<b>5,620,850</b>	<b>5,855,808</b>	<b>5,397,197</b>	<b>5,124,039</b>	<b>7,493,347</b>
1	Buxheti I Shtetit (përfshirë TVSH dhe kosto lokale)	1,437,882	1,942,952	2,009,197	1,862,424	2,372,116	2,494,078	2,412,877	2,582,810	3,125,538
2	Donatoret e Huaj	1,946,912	3,104,483	2,488,685	3,606,752	2,988,946	2,994,658	2,912,696	2,414,190	4,286,275
3	FZSHH	708,145	394,426	107,900	352,653	259,788	367,072	71,624	127,039	81,534

**INVESTIME, UJESJELLES KANALIZIME, 2008**

000/leke

NR.	EMËRTIMI I SHOQËRISË SIPAS QARKUT	NJËSITE VENDORE TE ZONËS SE SHËRBIMIT TE SHOQËRISË	POPULLSIA	2008	
				BUXHETI SHTETIT	FINANCIM I HUAJ
<b>INVESTIME TOTALE, UJESJELLES KANALIZIME</b>				<b>3,207,072</b>	<b>4,286,275</b>
<b>I. QARKU DURRES</b>				<b>369,191</b>	<b>174,577</b>
1	Sh.A. UK Durrës	Bashkia: Durrës, Shijak, Sukth, Manez; Komuna: Thumane, Ishem, Xhafzotaj, Rrashbull, Katund I Ri, Bubq, Preze, Fushe-Kuqe, Maminas, Gjepalaj	351,498	306,191	108,112
2	Sh.A. UK Kruje	Bashkia Kruje, Komuna Cudhi.	19,514	11,000	55,000
3	Sh.A. UK Fushe Kruje	Fushe Kruje.	45,000	52,000	11,465
<b>II. QARKU ELBASAN</b>				<b>100,091</b>	<b>0</b>
1	Sh.A. UK Elbasan(Q)	Bashkia Elbasan, Komuna Bradashesh (pjes.).	131,643	16,000	
2	Sh.A. U Elbasan (F)	Bashkia: Cerrik, Belsh; Komuna Grekan, Gostime, Shales, Kajan, Rase, Fierze, Paper, Gjergjan, Mollas, Bradashesh, Gracen, Zavaline, Labinot Fushe, Labinot Mal, Shirgjan, Shushice.	141,543	24,004	
3	Sh. A. U Peqin	Bashkia Peqin; Komuna: Sheze.	14,138	36,788	
4	Sh.A. UK Librazhd	Bashkia Librazhd.	19,187	23,299	

<b>III. QARKU FIER</b>				<b>194,226</b>	<b>585,002</b>
1	Sh.A. UK Fier	Bashkia: Fier, Roskovec, Divjake; Komuna: Topoje, Seman, Dermenas, Levan, Frakull, Kuman.	146,847	87,906	249,704
2	Sh.A.UK Mallakastër	Bashkia Ballsh; Komuna: Qender Dukas, Aranitas, Hekal, Kute, Fratar.	38,090	8,000	
3	Sh.A. UK Lushnjë (Q)	Bashkia Lushnje.	55,000	35,400	335,298
4	Sh.A. U Lushnjë (F)	Komuna Karbunare, Kolonja, Libofsh, Dushk, Fier Shegan, Allkaj, Bubulline, Krutje, Poshnje, Gradisht, Remas.	104,095	62,920	
<b>IV. QARKU GJIROKASTER</b>				<b>98,442</b>	<b>0</b>
1	Sh.A. U Gjirokastër(Q)	Bashkia Gjirokastër, komuna Lunxheri.	37,241	22,552	
2	Sh.A. U Gjirokastër(F)	Komuna Lunxhëri (pjes), Qender Libohove, Lazarat, Cepo, Antigone, Odrie, Picar, Zagori, Dropull I Sipërm, Dropull I Poshtëm.	41,905	21,000	
3	Sh.A. UK Tepelene	Bashkia Tepelene.	33,050	35,040	
4	Sh.A. UK Përmet	Bashkia Permet, Komuna: Petran.	13,830	19,850	
<b>V. QARKU KORÇE</b>				<b>261,059</b>	<b>1,455,614</b>
1	Sh.A. UK Korçë (Q)	Bashkia Korçë	86,040	100,600	390,000
2	Sh.A. U Korça (F)	Bashkia Maliq; Komuna: Drenove, Voskop, Qendër Bulgarec, Pojan, Proger, Vreshtas, Libonik.	86,680	43,000	
3	Sh.A. U Bilisht	Bashkia Bilisht.	9,704	26,051	10,614
4	Sh.A.UK Pogradec	Bashkia Pogradec, Komuna Buçimas.	55,755	80,408	1,055,000
5	Sh.A.UK Erseke	Bashkia Erseke.	5,900	11,000	
<b>VI. QARKU KUKES</b>				<b>105,156</b>	<b>0</b>
1	Sh.A. UK Kukës	Bashkia Kukes; Komuna: Shtiqen, Bicaj.	31,770	25,476	
2	Sh.A. U Has	Bashkia Krumë; Komuna: Fajza, Gjinaj.	13,453	15,000	
3	Sh.A. U Tropojë	Bashkia Bajram Curri; Komuna: Margegaj, Tropojë, Bujan, Llugaj, Fierze, Bytyc.	28,168	64,680	
<b>VII. QARKU LEZHE</b>				<b>290,260</b>	<b>30,134</b>
1	Sh.A. UK Lezhe	Bashkia Lezhe; Komuna: Shëngjin, Balldren.	47,565	249,489	30,134
2	Sh.A. UK Kurbin	Bashkia Laç, Mamurras, Milot.	64,549	36,515	

3	Sh.A. UK Mirdite	Bashkia Rreshen; Komuna: Selite, Orosh.	17,593	4,256	
<b>VIII. QARKU SHKODER</b>				<b>419,682</b>	<b>71,516</b>
1	Sh.A. UK .Shkoder(Q)	Bashkia Shkodër.	112,783	117,349	12,792
2	Sh.A. U Shkodër (F)	Komuna Bërdicë, Velipojë, Hajmel, Gur I Zi, Ana e Malit, Shale, Rrethina.	90,221	240,400	23,054
3	Sh.A. UK M. Madhe	Bashkia Koplik; Komuna Shkrel, Qendër Koplik, Kastrat, Kelmend, Grumeira.	54,418	86,921	35,670
4	Sh.A. UK Puke	Bashkia Puke; Komuna: Rrape, Qafe Mali, Gjegjan, Blerim, Qelez, Fierze, Qerret, Iballe.	29,305	13,210	
5	Sh.A. U F. Arrëz	Bashkia F.Arez.	4,735	7,000	
<b>IX. QARKU TIRANE</b>				<b>446,505</b>	<b>609,730</b>
1	Sh.A. UK Tirane	Bashkia Tirane, Kamez, Vore; Komuna: Berzhite, Shengjergj, Preze, Petrelë, Dajt, Baldushk, Paskuqan, Zall Herr, Kashar, Farke, Krrabë, Bërxull, Vaqarr.	836,067	373,648	519,000
2	Sh.A. UK Kavajë	Bashkia Kavajë; Komuna: Synej, Golem, Helmes, Lekaj, Luz I Vogël, Kryevish	91,848	72,857	90,730
3	Sh.A. UK Rrogozhine	Bashkia Rrogozhine; Komuna: Gose, Sinaballaj.	21,241		
<b>X. QARKU BERAT</b>				<b>64,410</b>	<b>81,549</b>
1	Sh.A. UK Berat	Bashkia Berat; Komuna: Vertop, Otlak.	84,257	60,410	81,549
2	Sh.A. U Skrapar	Bashkia Corovode; Komuna: Qender, Gjerbes, Kotom, Cepan, Vendresh, Bogove, Zhep.	23,619	4,000	
<b>XI. QARKU VLORE</b>				<b>377,003</b>	<b>614,645</b>
1	Sh.A. U Vlore	Bashkia Vlore, Himare; Komuna: Shushice, Armen, Qender.	174,953	158,512	584,550
2	Sh.A. UK Sarande	Bashkia Sarande; Komuna: Dhiver, Aliko, Mesopotam, Finiq.	61,941	211,491	30,095
3	Ujësjetës Novosele	Komuna Novosele.	19,489	7,000	
<b>XII. QARKU DIBER</b>				<b>150,740</b>	<b>56,741</b>
1	Sh.A. UK Peshkopi	Bashkia Peshkopi; Komuna: Kala e Dodes, Sillove, Fushe Cidhen, Luzi, Kastriot, Qender Tomin.	50,184	88,846	14,696
2	SH.A U Bulqizë	Bashkia Bulqizë; Komuna Shupenze, Zerqan.	18,305	5,394	29,000
3	SH.A U Mat	Bashkia Burrel, Komuna: Lis.	45,846	56,500	13,045

<b>TE TJERA: (56 komuna te cilat nuk janë te përfshira ne zonat e shërbimit te 56 shoqërive UK)</b>		<b>288,450</b>	<b>492,033</b>
<b>I</b>	Qarku Elbsan	Komuna: Pajove, Gjinar, Rajce, Gjocaj, Qukes	
<b>II</b>	Qarku Fier	Komuna: Cakran, Strume, Golem, Selite, Hysgjokaj	
<b>III</b>	Qarku Gjirokaster	Komuna: Dropulli i siperm, Dishnice, Pogon, Piskove, Carshove, bashkia Kelcyre	
<b>IV</b>	Qarku Korce	Komuna: Voskopoje, Hociisht, Qender Bilisht, Cerrave, Dardhas, Hudenisht, Mollas, Mollaj, bashkia Leskovik	
<b>V</b>	Qarku Kukes	Komuna Kolsh, Shishtavec	
<b>VI</b>	Qarku Lezhe	Komuna: Shenkoll, Blinisht, Zejmen, Kolsh, Dajc, Kallmet	
<b>VII</b>	Qarku Shkoder	Komuna: Rioll, Bushat, Barbullush, Shiroke.	
<b>VIII</b>	Qarku Tirane	Komuna: Peze, Ndroq	
<b>IX</b>	Qarku Berat	Komuna Velabisht	
<b>X</b>	Qarku Vlore	Komuna: Kote, Vllahine, Brataj, Ksamil, Livadhja	
<b>XI</b>	Qarku Diber	Komuna: Melan, Selishte, Muhur, Ostren, Macukull, Gurre, Zerqan, Suc, Derjan, Klos, Komsj.	

**TABELA 2**  
**PLANI I NDËRTIMIT TE IMPIANTEVE TE TRAJTIMIT TE UJIT TE NDOTUR TE KANALIZIMEVE NE SHQIPËRI, 2005 – 2010**

Nr.	Zona e shërbimit	Qeveria me donatore si:	Teknologjia	Statusi	Kosto (EURO)	Popullsia e shërbyer	Fillimi	Përfundimi
1	Kavajë	KfW	Pond, me pas Filtër me pikim	Ne funksionim	€ 5,0 mil	25,000	tetor 2004	maj 2005
2	Kavajë plazhi	IPF-BE	Pond, me pas Filtër me pikim	Negocim	€ 5,0 mil	25,000	tetor 2009	maj 2010
3	Durrës	BB/LUX/BEI/BE	Kovencional, me pas nivel terciar	Ne ndërtim	€ 10,5 mil	250,000	mars 2007	mars 2009
4	Lezhe-Shëngjin	BB/LUX/BEI/BE	Kovencional, me pas pellg artificial trajtimi	Ne ndërtim	€ 3,7 mil	42,000	mars 2007	mars 2009
5	Sarande	BB/LUX/BEI/BE	Kovencionale, me pas pellg artificial trajtimi	Ne ndërtim	€ 3,8 mil	60,000	mars 2007	mars 2009
6	Vlore	CARDS (BE)	Kovencionale , me pas pellg artificial trajtimi	Ne ndërtim	€ 2,7 mil	150,000	tetor 2006	dhjetor 2007
7	Pogradec	KfW	Pond, me pas Filter me pikim	Ne ndërtim	€ 5,0 mil	54,997	prill 2007	prill 2008
8	Korçë	BEI/KfW	Kovencional ne nivelin sekondar	Ne Tender	€ 7,0 mil	86,000	shtator 2008	dhjetor 2009
9	Tirane	JICA	Kovencional ne nivelin sekondar	Projektim	€ 67,0 mil	850,000	dhjetor 2009	dhjetor 2011
10	Narte/shkolle 9vjecare	UNDP/MMPAU	Pellg Artificial Trajtimi	Ne funksionim	€ 0,28 mil	200 fëmijë	gusht 2007	dhjetor 2007
11	Projekt-Pilot me kosto te ulet	GTZ/MPPTT	Sanitet Ekologjik	Projektim	€ 0,25 mil	Në proces	shkurt 2008	qershor 2009
<b>Kosto Totale / Popullsia Totale e Shërbyer</b>					<b>€ ~111 milion</b>	<b>~1.6 milion banorë</b>		